

...vijon nga numri i kaluar

GJON BORIÇI

Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë
gjon.borici@asa.edu.al

NJË VËSHTRIM NË TERMA POLITIKO-EKONOMIKË NDËRMJET SHQIPËRISË DHE JUGOSLLAVISË NË PERIUDHËN 1945-1949 (Pjesa e dytë, korrik 1947- mars 1948)

Abstrakt:

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në periudhën 1947-1948 patën problematika të mprehta. Në këtë pjesë të dytë të artikullit do të përqendrohemi te vijimi i varësisë së plotë ekonomike dhe politike të qeverisë shqiptare ndaj Jugosllavisë, politike sanksionuar me vendimet e Plenumit VIII të PKSH-së. Me anë të dokumenteve arkivore, ku jo pak prej tyre paraqiten për herë të parë kombinuar edhe me literaturën bashkëkohore ndërkombëtare, lexuesi i interesuar ballafaqohet me fakte tronditëse të cilat pasqyrojnë më së miri shkallën tepër të ulët të njohurive politiko-ekonomike të lidërshpit komunist shqiptar në marrëdhënien me udhëheqjen jugosllave. Shqipëria, edhe pse po merrte kredi nga Jugosllavia dhe nga Bashkimi Sovjetik në këtë hark të shkurtër kohor për të mos përfunduar në katastrofë financiare, përsëri ekonomia e saj dhe rrjedhimisht standardi i jetesës së popullit shqiptar vijonte të ishte në nivele tepër të ulëta. Lideri komunist shqiptar, Enver Hoxha, e tregoi veten një vasal të bindur të kërkesave jugosllave kur u parashtrua çështja e bashkimit të të dyja vendeve në një Federatë të përbashkët. Nëpërmjet hulumtimit të kujdesshëm të materialeve arkivore dhe të literaturës ndërkombëtare, lexuesi i interesuar do të njohë me detaje të bollshme atmosferën politike që ekzistonte në atë kohë në Shqipëri, bindjen e plotë ndaj çdo "miqësie" të pathyeshme me cilindo shtet komunist që dërgonte kredi dhe ndihma. Metodologjia e përdorur në këtë artikull është analitiko-ekonomike, bazuar në dokumentacion arkivor dhe literaturën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fjalë kyçe:

Enver Hoxha, Tito, Stalin, ideologji, ekonomi, kredi, federatë.

Hyrje

Nuk ishte e thjeshtë për qeverinë komuniste shqiptare që të aplikonte çdo kërkesë të jugosllavëve, por ishte shumë e thjeshtë për Kryeministrin Enver Hoxha të pranonte çdo dëshirë të tyre. Një nga pyetjet që shtrohen në këtë artikull është se përse Shqipëria refuzoi me dëshirë çdo bashkëpunim tjetër ekonomik me Perëndimin duke refuzuar planin Marshall e duke iu falur e tëra Jugosllavisë, thuajse gratis? Çfarë do të merrte në këmbim Shqipëria ndaj pranimet me bindje të plotë të supremacisë së Jugosllavisë? Humbjes së pavarësisë së saj politike në fakt i kishte paraprirë humbja e pavarësisë ekonomike. Jugosllavia u tregua pakrahasimisht më fleksibël sesa Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare duke mos u përqendruar vetëm te marrëdhënia e ngushtë me Bashkimin Sovjetik. Edhe pse kishte prani të konsiderueshme të personelit ushtarak sovjetik në vend, Titoja arriti të manovronte me shumë shkathtësi në labirintet e pushtetit komunist në vendin e tij. Ai ndoqi një politikë të pavarur të jashtme dhe, mbi të gjitha, për të ruajtur një ekuilibër të admirueshëm ndërmjet dy blloqeve kundërshtarë në Luftën e Ftohtë, duke bashkëpunuar ekonomikisht dhe rrjedhimisht politikisht me ofruesin më të mirë duke guxuar të refuzonte Stalinin dhe këshilltarët e tij politikë të drejtonin vendin e tij.¹ Liderhipi i Jugosllavisë socialiste kishte një eksperiencë shumë herë më të avancuar sesa udhëheqja komuniste shqiptare. Skajshmërisht të fiksuar pas ideologjisë dhe pushtetit absolut, komunistët shqiptarë gabonin në një prej elementeve më thelbësore të menaxhimit të pushtetit. Nuk ekziston pushteti i qëndrueshëm politik nëse nuk arrihet të sigurohet pavarësia ekonomike. Këtë mësim të çmuar, udhëheqja komuniste shqiptare nuk do ta merrte asnjëherë parasysh dhe deri në gjysmën e dytë të viteve '70 të shek. XX, vendi do të ishte gjithnjë i varur nga ndihmat dhe kreditë e vendeve të Kampit Socialist (1945-1960)² dhe nga Republika Popullore e Kinës (1954-1975).³ Kur refuzoi të merrte ndihma, sistemi komunist

¹ Vojtech Mastny, *Il dittatore insicuro: Stalin e la Guerra Fredda*, përkthyer nga anglishtja prej Annalisa Agratit (Milano: Tea, 1998), 44.

² Shih gjerësisht: Gjon Boriçi, *Fillimet e marrëdhënieve politiko-ekonomike shqiptaro-kineze 1954-1960* (Tiranë: Geer, 2023).

³ Shih gjerësisht: Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1978*, bot. II (Tiranë: Geer, 2022).

falimento brenda një dekade. Edhe në rastin konkret të marrëdhënies me Jugosllavinë, Shqipëria u mjaftua vetëm me dëshirën e mbijetesës politike të lidershit të saj, jo me parashikueshmërinë e së ardhmes. Një tjetër pyetje e këtij artikulli ka të bëjë me faktin se sa konsiderohej prej lidershit komunist shqiptar mbijetesja e vendit. Diktatura e dhunshme që ishte instaluar në vend nuk mund të mbante përjetësisht pushtetin vetëm me forcën e armëve. Kjo për një fakt shumë të thjeshtë. Njerëzimi është i papërshtatshëm për të përqaftuar utopinë.⁴ Në fakt, kjo e fundit (utopia) i imponua totalisht popullit shqiptar nga qeveria komuniste për 45 vjet, duke sjellë një shpërlarje kolektive të trurit, recidivat e së cilës fatkeqësisht janë të pranishme edhe në ditët tona.

Problematikat shqiptaro-jugosllave në gjysmën e dytë të vitit 1947 dhe pranimi i Shqipërisë për të bërë pjesë në një konfederatë të përbashkët me Jugosllavinë

Më datë 1 korrik 1947, Byroja Politike e KQ të PKSH-së bëri një mbledhje mbi disa vërejtje të parashtruara nga udhëheqja jugosllave mbi planin ekonomik ndërmjet dy vendeve.⁵ Vetë udhëheqja jugosllave nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Tiranë, Savo Zllatiç, i kishte dërguar një letër KQ të PKSH-së ku shpreheshin pakënaqësitë e Jugosllavisë në marrëdhëniet ekonomike me Shqipërinë dhe jo vetëm ato.⁶ Në lidhje me këto çështje, Enver Hoxha personalisht i kërkoi Nako Spirut që të bënte sqarimet e duhura përpara Byrosë Politike. Spiru ishte i vetmi që kishte biseduar më shumë nga të gjithë anëtarët e tjerë të udhëheqjes komuniste shqiptare me jugosllavët. Në mbledhje, Spiru deklaroi se pas takimit që kishte pasur me Zllatiçin, ky i fundit ishte shprehur se çështjet ekonomike ndërmjet dy vendeve po ecnin ngadalë.⁷ Një nga shqetësimet kryesore të përfaqësuesit jugosllav ishte se ende ndërmjet dy vendeve nuk ishte vendosur pariteti i çmimeve sipas akordit të nëntorit të vitit 1946. Madje,

⁴ J. Bradford DeLong, *Slouching towards utopia; an economic history of the Twentieth Century* (London: Basic Books, 2022), 22.

⁵ *Arkivi Qendror i Shtetit i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 14/Organet Udhëheqëse (më tej: OU), Viti (më tej: V.) 1947, Dosja (më tej: D.) 20, fl. 14. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, më datë 1 korrik 1947, mbi diskutimin rreth vërejtjeve për çështje të planit dhe akuzave të udhëheqjes jugosllave kundër PKSH-së.

⁶ *Po aty*.

⁷ *Po aty*.

diplomati jugosllav kishte shkuar edhe më tej kur i kishte deklaruar Spirit se shqiptarët që kishin shkuar për bisedime nuk e kuptonin vijën ekonomike.⁸

Përse ky qëndrim i papritur nga pala jugosllave në marrëdhëniet me Shqipërinë? Përgjigjen për këtë na e jep vetë diskutimi i Spirit i cili shtoi se, Zllatiçi në emër të udhëheqjes jugosllave nuk e konsideronte serioze ndërhyrjen e inxhinierëve sovjetikë në ndërtimin e hekurudhës (Durrës-Peqin) dhe kjo vijë ishte në kundërshtim me vijën e deritanishme në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.⁹ Afrimi shqiptaro-sovjetik edhe në çështje teknike pa dyshim që nuk mund të shihej me sy të mirë nga jugosllavët. Kishte qenë vetë Stalini i cili kishte pranuar në bisedimet me Kardejlin (Edvard Kardejli – anëtar i presidencës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë) që Shqipëria edhe mund të gëlltitej nga Jugosllavia.¹⁰

Sipas Zllatiçit, çështja e paritetit të çmimeve duhej të kishte përfunduar në fund të muajit maj dhe udhëzimet për tregtinë të cilat qeveria shqiptare duhej t'i jepte që në muajin prill, ende nuk ishin dhënë.¹¹ Nga e gjithë Byroja Politike u arrit në konkluzionin se vërejtjet e Zllatiçit (të Jugosllavisë) ishin të nxituara, por megjithatë sipas fjalës përmbyllëse të Enver Hoxhës ai mund të bindej për të kundërtën pasi ishte një njeri i arsyeshëm.¹²

Vetëvrasja e Nako Spirit dhe pranimi i udhëheqjes komuniste shqiptare për bashkim me Jugosllavinë

Më datë 3 nëntor 1947, Byroja Politike e KQ të PKSH-së zhvilloi një mbledhje të posaçme në të cilën dy ishin çështjet më me rëndësi që u diskutuan. *Së pari*, raporti i Kiço Ngjelës mbi frymën që duhej të kishte plani i parë pesëvjeçar duke u bazuar në kushtet e Shqipërisë dhe, *së dyti*, refuzimi i projektit jugosllav dhe moskoordinimi me planin e tyre pesëvjeçar.¹³ Le t'i shohim të dyja pikat me radhë.

⁸ *Po aty*.

⁹ *Po aty*, fl. 15.

¹⁰ Islam Lauka & Eshref Ymeri, *Antologjia e Kryqëzimit; Rusia dhe çështja shqiptare (1878-2012)* (Prishtinë-Tiranë: City Design: 2012), 37.

¹¹ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1947, D. 20, fl. 16.

¹² *Po aty*, fl. 20.

¹³ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1947, D. 31, fl. 1. Procesverbal i mbledhjes në dy variante të Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, 3 nëntor 1947.

Sipas Ngjelës në diskutimet që kishte pasur Nako Spiru me jugosllavët, këta të fundit e kishin refuzuar idenë që Shqipëria të kishte një plan të vetin pesëvjeçar, por të përpilohej një plan trevjeçar që të fillonte më 1948 dhe të mbaronte në vitin 1950.¹⁴ Jugosllavët, sipas Ngjelës, kishin ndryshuar mendje në takimin që ishte zhvilluar më 16 prill, ku Kidriçi (Boris Kidrič, kryetar i Këshillit Ekonomik Jugosllav) u kishte kërkuar që edhe Shqipëria të hartonte një plan pesëvjeçar dhe në Beograd të hidheshin vijat e përgjithshme të tij.¹⁵ Për hartimin e planit pesëvjeçar të Shqipërisë, Jugosllavia kishte dërguar në Tiranë me porosi të qarta sipas Ngjelës inxhinier Troiskin (në dokument nuk jepet emri dhe pozita e tij) i cili ishte personi “kyç” i tyre për të hartuar dhe menaxhuar planin për Shqipërinë.¹⁶ Ishte mjaft e dukshme se plani i parë pesëvjeçar i Shqipërisë nëse do të aprovohej nga Byroja Politike sipas parashikimeve jugosllave, do të sillte varësinë e plotë të vendit që edhe në ato kushte ishte gjysmë i varur nga Jugosllavia e Titos.

Varianti i dytë i kësaj mbledhjeje është më i ashpër. Sipas këtij varianti, raportuesi Kiço Ngjela deklaronte se tashmë marrëdhëniet dhe bisedat me inxhinier Troiskin nuk ishin më aq miqësore. Për më tepër, inxhinieri jugosllav këmbëngulte se kishte porosi të parashtronte udhëzimet që kishte marrë nga qendra dhe se duhej që shqiptarët t'i studionin ato dhe në dukje të vendosnin vetë.¹⁷ Shqipëria nuk ishte në gjendje ekonomike për të përballuar një plan pesëvjeçar, të paktën jo pa ndihma konkrete në kredi nga jashtë. Sipas këtij raporti, në kundërshtim me tezat jugosllave të hartimit të planit dhe të varësisë së plotë të Shqipërisë ndaj politikave ekonomike jugosllave, ishte edhe Nako Spiru.¹⁸ I vetmi që doli hapur në përkrahje të planit ekonomik jugosllav ishte Koçi Xoxe, i cili në fjalën e tij u shpreh se politikat ekonomike të mareshalit (Titos), Markos (në dokument nuk jepet emri dhe pozita e tij), Zllatiçit ishin krijimi i shoqërive për të ndihmuar Shqipërinë.¹⁹ Madje, Xoxe shkoi edhe më tej kur deklaroi se këto propozime të Jugosllavisë, Nako Spiro "i nxirrte me gjysëm zemre".²⁰

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *Po aty*.

¹⁶ *Po aty*, fl. 3.

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *Po aty*, fl. 18.

¹⁹ *Po aty*.

²⁰ *Po aty*.

Dukej qartë se në Byronë Politike duke hulumtuar me kujdes këtë raport, ishin përvijuar dy rryma të kundërta brenda saj. E para, e përfaqësuar nga Këçi Ngjela dhe Nako Spiru që kundërshtonin tezat jugosllave dhe e dyta, e përfaqësuar nga Koçi Xoxe dhe Enver Hoxha që pranonin propozimet jugosllave. Enver Hoxha në fakt, duke hulumtuar këtë dosje në variantin e parë del se ka mbajtur një qëndrim pro ndaj propozimeve jugosllave, ndërsa në variantin e dytë nuk paraqitet qartë asnjë mendim i tij lidhur me çështjen në fjalë.

Përplasja e këtyre dy rrymave në Byronë Politike bëri që në datat 18-19 nëntor 1947, Byroja Politike të thërriste një tjetër mbledhje urgjente ku do të diskutohej në mënyrë përfundimtare nëse do të pranohej apo jo propozimi jugosllav për planin e parë pesëvjeçar.²¹ Sipas Xoxes, i cili ishte një nga nismëtarët e thirrjes së kësaj mbledhjeje së bashku me Enver Hoxhën, deklaroi se baza e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishte prishur.²² Lidhur me këtë, Xoxe akuzoi direkt Nako Spirun i cili sipas tij duhej të përgjigjej se përse gjërat kishin precipituar në këtë situatë.²³ Enver Hoxha, nga ana e tij, i cilësoi pretendimet e jugosllavëve të peshuara.²⁴ Edhe Shulja (Kristo Themelko) i doli në krah Hoxhës duke thënë se fjalët e Zllatiçit ishin të vërteta.²⁵ Madje, Themelko shkoi edhe më tej duke deklaruar se, duke folur më shumë për Bashkimin Sovjetik e teknikët sovjetikë kishte shkaktuar përbuzje ndaj Jugosllavisë dhe, sipas tij, ky ka qenë edhe qëllimi i armikut dhe për këtë kërkoi shpjegime nga Nako Spiru.²⁶

I gjendur përballë një presioni të tillë, Spiru tentoi të fitonte kohë e cila nuk iu dha. Vetë Enver Hoxha i kërkoi që të diskutonte për problemet ekonomike të cilat, sipas tij, ai [Spiru] i dinte mirë.²⁷ Spiru përsëri refuzoi. Atëherë Enver Hoxha pranoi dhe deklaroi se mbledhja do të vijonte një ditë më pas, në datën 19 nëntor.²⁸ Kësaj here Spiru nuk

²¹ AQSH, F. 14/OU, V. 1947, D. 33, fl. 9. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, në datat 18-19 nëntor 1947, për sa u përket akuzave të bëra nga KQ i PKJ-së kundër PKSH-së lidhur me marrëdhëniet me Jugosllavinë.

²² *Po aty*. Shënim. Në bisedimet e zhvilluara në Tiranë ndërmjet Hoxhës dhe Zllatiçit, Koçi Xoxe ishte përkthyesi.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*.

²⁵ *Po aty*.

²⁶ *Po aty*, fl. 10.

²⁷ *Po aty*, fl. 11.

²⁸ *Po aty*.

mund të shmangej më. Megjithatë, përsëri kërkoi të fitonte kohë duke kërkuar që të shtyhej mbledhja edhe për 4-5 ditë. Enver Hoxha e kundërshtoi duke deklaruar se kjo sjellje nuk ishte e shëndoshë dhe se diskutimet nuk do të shtyheshin.²⁹ Pro fjalës së Hoxhës u deklarua Xoxe, Kristo (Pandi) dhe Tuk Jakova. Duke parë që njerëzit kryesorë të Byrosë i kërkuan Spirut të fliste, e gjithë anëtarësia aprovoi mendimin e tyre. Por Spiru nuk u dorëzua dhe përsëri kërkoi 4-5 ditë kohë për t'u përgatitur.³⁰ Enver Hoxha i dha afat deri të nesërmen në darkë të datës 20 nëntor 1947 dhe kjo do të ishte përfundimtare.³¹

Nako Spiru nuk do të paraqitej në mbledhjen e datës 20 nëntor. Paraditen e asaj date, ai u gjet i vdekur në zyrë dhe autoritetet shpejtuan ta deklararin vdekjen e tij si vetëvrasje apo aksident në zyrë.³² Tronditja në dukje e autoriteteve shqiptare ishte e madhe. Pas kapërcimit të kësaj situate, Byroja Politike u mbledh përsëri për të diskutuar lidhur me përshtatjen e planit pesëvjeçar ekonomik të vendit me atë jugosllav më datë 29 nëntor 1947.³³ Në këtë mbledhje u sulmua vija e mbajtur nga Nako Spiru kundrejt jugosllavëve nga Koçi Xoxe, i cili nuk la pa përmendur edhe qëndrimin që kishte mbajtur Kiço Ngjela në përkrahje të kësaj vije.³⁴ Enver Hoxhës për momentin nuk i interesonte të godiste hapur edhe një tjetër anëtar të Byrosë Politike, kur sapo kishte çuar në vetëvrasje sipas versionit zyrtar Nako Spirun. Hoxha bëri sikur nuk e kuptoi atë çfarë diskutoi Xoxe dhe pyeti Ngjelën se përse kishte kërkuar që vendi të porosiste një fabrikë për prodhimin e pambukut nga Bashkimi Sovjetik dhe nëse kjo fabrikë do të mbulonte të gjithë prodhimin e këtij materiali në vend.³⁵

Kiço Ngjela kërkoi kohë e cila iu dha për të diskutuar. Byroja u mbledh përsëri në një mbledhje të posaçme më datë 2 dhjetor 1947.³⁶

²⁹ *Po aty*.

³⁰ *Po aty*, fl. 13.

³¹ *Po aty*, fl. 14.

³² Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1978* (Tiranë: Mirgeeralb, 2016), 37; shih edhe Mastny, *Il ditatore insicuro*, 42.

³³ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1947, D. 34, fl. 1. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, i datës 29 nëntor 1947, ku u diskutua rreth planit 5-vjeçar dhe përshtatjes së tij sipas diktimeve jugosllave.

³⁴ *Po aty*, fl. 5-6.

³⁵ *Po aty*, fl. 6.

³⁶ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1947, V. 1947, fl. 1. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, më datë 2 dhjetor 1947, lidhur me raportimin e Kiço Ngjelës mbi

Kësaj here, Ngjela në fjalën e tij ia "vesh" të gjithë fajin për mospranimin e propozimit jugosllav për planin të ndjerit Nako Spiru.³⁷ Gjithashtu, Ngjela për të mos hedhur plotësisht baltë mbi veten theksoi në mbledhje se aprovonte me disa propozime (të parëndësishme) të gjithë planin e hartuar prej jugosllavëve lidhur me shpenzimet që parashikoheshin për të përmbushur me sukses këtë plan.³⁸ Tashmë, shpenzimet që do të kërkonte plani i parë pesëvjeçar nga ana e Shqipërisë me ndihmën e Jugosllavisë nuk do të ishin më 2 miliardë dinarë, por 21 miliardë dhe ky fakt i ishte aprovuar edhe në bisedimet që kishte zhvilluar në Beograd, pa specifikuar në dokument se në ç'datë.³⁹

Ishte e qartë se plani i parë pesëvjeçar i Shqipërisë ishte hartuar tërësisht sipas interesave të Beogradit zyrtar. Deri në këtë moment, ishte një arritje e madhe për politikën jugosllave e cila ia kishte dalë mbanë deri tani të skllavëronte ekonomikisht Shqipërinë. Lidhur me këtë fakt, lexuesi është i lutur të presë pjesën e fundit të këtij studimi për sa i përket varësisë ekonomike të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë të përgatitur në të tjera rrethana në shtator të vitit 1949 prej Kiço Ngjelës, Abdyl Këllezit, Manol Konomit dhe Spiro Kolekës ku del se sa të drejtë kishte pasur Nako Spiru. Po në vitin 1947, kur Shqipëria ia kishte hequr vetes të gjitha mundësitë e një bashkëpunimi ekonomik me Perëndimin dhe kishte goditur të gjithë shtresën e tregtarëve privatë të brendshëm, e vetmja mundësi për mbijetesë ekonomike dhe rrjedhimisht politike për momentin ishte politika e bindjes ndaj Jugosllavisë.

Mbledhja e 2 dhjetorit u pasua nga një tjetër mbledhje e Byrosë Politike, më 5 dhjetor 1947, ku u denoncua edhe një herë vija e gabuar që kishte mbajtur Nako Spiru ndaj Jugosllavisë.⁴⁰ Si për të treguar besnikërinë ndaj Jugosllavisë, në këtë mbledhje u lexuan të gjitha telegramet që kishte dërguar nga Beogradi Nako Spiru kur kishte qenë

mbështetjen e planit të parë pesëvjeçar sipas direktivave jugosllave dhe ndaj qëndrimit antijugosllav të Nako Spirut.

³⁷ *Po aty*, fl. 1-2.

³⁸ *Po aty*, fl. 2.

³⁹ *Po aty*, fl. 3.

⁴⁰ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1947, D. 37, fl. 1. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, më datë 5 dhjetor 1947, ku u diskutua mbi situatën e krijuar në lidhje me marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe qëndrimin e Nako Spirut e të tjerëve (teknikë) që kishin folur kundër Jugosllavisë.

për bisedime ekonomike atje, dhe se çfarë përgjigjesh i kishte dhënë udhëheqja komuniste shqiptare qëndrimit të tij të gabuar.⁴¹

Për qëndrimin e Nako Spirut kundër jugosllavëve, Byroja Politike bëri mbledhje pas mbledhjeje për t'i treguar Jugosllavisë se sa shumë e dënonte qëndrimin e tij dhe sa gabim kishte bërë udhëheqja komuniste shqiptare që i kishte besuar një detyrë kaq delikate për të negociuar marrëdhëniet me fqinjën verilindor. Sipas dokumenteve që kam hulumtuar, Nako Spiru, marrëdhëniet me Jugosllavinë nuk i shihte me syrin e një komunisti sipas Byrosë Politike, por me ndjenja shoviniste dhe mikroborgjeze.⁴²

Në mbledhjen e Byrosë të datës 7 dhjetor 1947, u lexuan "propozimet" e Savo Zllatiçit ku kërkohej qartë një bashkim "vullnetar" i Shqipërisë me Jugosllavinë në mënyrë që vendi të kthehej në një republikë të shtatë të Jugosllavisë, pikëpamje që u mbrojt nga Koçi Xoxe.⁴³ Të gjitha këto pika u lexuan nga Enver Hoxha, i cili nuk i kundërshtoi ato.⁴⁴ Sipas Savo Zllatiçit, nëse Shqipëria binte dakord me planin jugosllav për bashkim, do të financonte në formë kredie shumë më 21 miliardë dinarë jugosllavë.⁴⁵ I ngazëllyer nga ky lajm, Koçi Xoxe si mbështetësi më i flaktë i kësaj politike deklaroi në fund të mbledhjes se:

⁴¹ *Po aty*, fl. 2-4.

⁴² *Po aty*, F. 14/OU, V. 1947, D. 39, fl. 37. Procesverbal, dorëshkrime dhe daktilografime me ndryshime të pjesshme të mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, më datë 6 dhjetor 1947, ku u diskutua mbi situatën e krijuar në lidhje me marrëdhëniet me Jugosllavinë si dhe për qëndrimin antijugosllav të Nako Spirut.

⁴³ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1947, D. 40, fl. 11. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike i datës 7 dhjetor 1947.

⁴⁴ *Po aty*. Pjesë nga fjala e Enver Hoxhës në këtë mbledhje: "Savo [Zllatiçi] shtroi një e nga një pikat që mendon K.C. i PKJ-së. 1) Afrimi dhe bashkëpunimi i ngushtë që të mbërrijmë në një vëllazërim dhe bashkim midis të dy popujve dhe me të tjerë popuj si me popullin bullgar. 2) Duke e parë kështu bashkëpunimin me një politikë të brendshme dhe të tillë do të jemi edhe në politikën e jashtme të një mendimi, të fortë dhe të lidhur kundër imperialistëve dhe nxitësve të luftës. Gjithë qëndrimi ynë jashtë duhet të karakterizohet nga një qëndrim i tillë".

⁴⁵ *Po aty*, fl. 14; Plani për bashkimin ndërmjet dy vendeve konfirmohet edhe nga studiuesi serb Vladimir Unkovski-Korica në studimin e tij. Për më tepër shih: Vladimir Unkovski-Korica, *The economic struggle for power in Tito's Yugoslavia; from World War II to Non-Alignment* (London: I.B. Tauris, 2016), 32; "Plani i parë pesëvjeçar në fakt parashikonte bashkimin rajonal me Shqipërinë, por jo me Bullgarinë që binte ndesh me preferencat sovjetike". Lidhur me planin e parë pesëvjeçar të Jugosllavisë, shih origjinalin në frëngjisht dërguar nga Beogradi qeverisë shqiptare në vitin 1947 në *AQSH*, F. 14/Strukturat (më tej: Str.), V. 1947, D. 330/1, fl. 55-147. "Ligj mbi planin

"...nji gja që ka rëndësi historike për vendin tonë asht që të kuptohet mirë se bashkëpunimi dhe bashkimi midis nesh asht i shëndoshë dhe me baza intencionaliste socialiste".⁴⁶

Enver Hoxha, siç e thamë edhe më lart, nuk u shpreh hapur nëse ishte dakord apo jo. Për t'i dhënë "drejtim" çështjes ai thirri një tjetër mbledhje të Byrosë Politike më datë 10 dhjetor 1947.⁴⁷ Në këtë mbledhje u vendos përfundimisht që plani i vitit 1948 të hartohej në përputhje të plotë me "rekomandimet" e udhëheqjes jugosllave dhe për herë të parë pas gjithë këtyre mbledhjeve, më në fund, Enver Hoxha nuk distancohet nga Xoxe dhe deklaroi hapur se ai bashkë me të kishin mendimin që të pranohej plani jugosllav për vitin 1948, arsyetim që u përforcua edhe nga Kiço Ngjela për arsye se investimet do të ishin të mëdha.⁴⁸

Përveç gabimeve të rënda ekonomike për të cilat jemi ndalur më lart, tashmë qeveria komuniste shqiptare po bënte gafën e radhës duke e varësuar totalisht vendin nën ndikimin ekonomik jugosllav që pa dyshim i paraprinte atij politik. Pas firmosjes së kësaj marrëveshjeje, nga Jugosllavia, do të vinin mallrat e cilësuara në marrëveshje të cilat thjesht shërbenin për të jetuar në kufijtë e mbijetesës për popullin shqiptar.⁴⁹ Po ashtu, transferimi i kapitaleve shqiptare në Jugosllavi ishte një tjetër hallkë që detyronte shtetin shqiptar të përmbushte sipas marrëveshjes së arritur me Jugosllavinë.⁵⁰ Jugosllavia kishte shkuar deri aty sa të detyronte Shqipërinë të caktonte të njëjtin kurs këmbimi edhe me levën bullgare sipas kursit të këmbimit dinar/levë.⁵¹ Kjo pasi ishte në synimet e Jugosllavisë të ndërtonte një federatë ballkanike trepalëshe me Bullgarinë

pesëvjeçar të rimëkëmbjes dhe të zhvillimit të ekonomisë kombëtare të BS për vitet 1946-1950 dhe projektplani pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë për vitet 1947-1951".

⁴⁶ *Po aty*, fl. 15.

⁴⁷ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1947, D. 42, fl. 1. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, më datë 10 dhjetor 1947, në të cilën jepen orientime për përgatitjen e planit të vitit 1948 mbështetur me ato të Jugosllavisë si dhe u rikritikua fryma e shkëputjes nga Jugosllavia që kishte nxitur Nako Spiru në lidhje me përgatitjen e planit pesëvjeçar.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 1, 9.

⁴⁹ *Po aty*, F. 506/Banka e Shtetit Shqiptar (më tej: BSHSH), V. 1947, D. 86, fl. 2, 5/1, 5. Dërgim mallrash nga Jugosllavia për përdorim të brendshëm në Shqipëri.

⁵⁰ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1947, D. 113, fl. 1. Transferim kapitali nga Shqipëria në Jugosllavi.

⁵¹ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1947, D. 89, fl. 1. Caktimi i kursit të këmbimit me lek/levë bullgare; 1 lek=5.70 leva, 1 dollar \$=450 leva, 16 tetor 1947.

dhe Shqipërinë.⁵² Lidhur me këtë çështje, vetë Stalini kishte dhënë fillimisht pëlqimin e tij duke thënë:

"Kjo është një federatë e cila duhet të krijohet dhe sa më shpejt aq më mirë - menjëherë po qe e mundur edhe nesër. Po qe nesër nëse është e mundur! Jam dakord menjëherë".⁵³

A e ka pranuar Byroja Politike e PKSHE-së krijimin e (Kon) Federatës Ballkanike gjatë mbledhjeve të saj dhjetor 1947-janar 1948?

Më datë 23 dhjetor 1947, Byroja Politike e KQ të PKSHE-së zhvilloi një mbledhje të rëndësishme në lidhje me vizitat e Kryeministrit Hoxha në Sofje dhe Beograd.⁵⁴ Në këto takime u diskutua sipas Enver Hoxhës mundësia e afrimit të mëtejshëm ekonomik ndërmjet të tria vendeve, e cila natyrshëm më vonë do të çonte në një konfederatë ballkanike që do të rriste sigurinë e rajonit në një botë bipolare.⁵⁵ Në këtë mbledhje, Enver Hoxha theksoi hapur se mbështeste pa doreza të gjitha sugjerimet e mareshalit [Titos] dhe se kriteret dhe vërejtjet e parashtruara nga PKJ-ja ishin të drejta.⁵⁶ Sipas Hoxhës, nëse do të konsolidohej afrimiteti ekonomik dhe plani për t'ia arritur këtij synimi do të ishte real, pa dyshim që do të ndikonte në zhvillimin e Shqipërisë.⁵⁷

Natyrisht që ishte një zhvillim i madh për politikën shqiptare, aq më tepër kur nuk ekzistonte më pengesa "Nako Spiru". Pas tri ditësh, më datë 26 dhjetor 1947, KQ-ja mblidhet përsëri për të diskutuar rreth propozimeve jugosllave, por më së shumti kjo çështje u anashkalua dhe u kalua si përherë te diskutimet mbi punën e armiqve sesa te propozimi jugosllav.⁵⁸ Nuk mund të kalonte kjo mbledhje pa lavdëruar ndihmën e paçmuar të PKJ-së për PKSHE-në, e cila, përveç të tjerave, kishte bërë të mundur edhe zbulimin e fraksioneve armiqësore ku më i rrezikshmi pa

⁵² Richard West, *Tito and the rise and fall of Yugoslavia* (London: Faber and Faber, 1996), 226.

⁵³ *Po aty*.

⁵⁴ *AQSH*, F 14/OU, V. 1948, D. 52, fl. 1. Raport mbi bisedimet e kryera nga delegacioni i lartë qeveritar në Sofje dhe Beograd.

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 97.

dyshim kishte qenë ai i Nako Spirit dhe Sejfulla Malëshovës.⁵⁹ Eksperienca jugosllave ishte e dobishme sipas diskutantëve, pasi PKSH-ja kishte mësuar prej saj se si të eliminonte kundërshtarët.⁶⁰ Ndërsa Hysni Kapo në fund të fjalës së tij, u shpreh hapur se PKSH-ja duhej të mbante lidhje të ngushta me PKJ-në dhe të mos ndahej asnjëherë prej saj dhe të ecte në rrugën e drejtë sipas këshillave të saj.⁶¹

Mbledhja e Byrosë Politike për të pranuar apo jo propozimin jugosllav për një konfederatë ndërmjet Jugosllavisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë ishte një maratonë e vërtetë. Më datë 30 dhjetor 1947, në seancën e radhës të mbledhjes së Byrosë, Koçi Xoxe si një nga ithtarët më të flaktë të afrimit të plotë me Jugosllavinë diskutoi mbi rëndësinë që do të kishte ky hap duke e vënë theksin te ndikimi që kishte ushtruar PKJ-ja në krijimin e PKSH-së.⁶² Madje, Xoxe shkoi edhe më tej kur propozoi se edhe kur të vinte puna për të diskutuar për kongresin e partisë, më parë udhëheqja duhej të këshillohej me jugosllavët dhe më pas me sovjetikët.⁶³

Sipas Xoxes duhej ndjekur çdo hap në çdo strukturë për të bërë të mundur realizimin e bashkimit me Jugosllavinë. Mbledhja maratonë e Byrosë rifilloi përsëri më 1 janar 1948, në të cilën Xoxe mori i pari fjalën për të diskutuar mbi bashkimin e ushtrisë shqiptare me atë jugosllave.⁶⁴ Metodrat e Nako Spirit dhe të Mehmet Shehut lidhur me pavarësinë e ushtrisë shqiptare, Xoxe i cilësoi me qëllime të caktuara indipendence dhe kryelartësie.⁶⁵

⁵⁹ *Po aty*, fl. 100.

⁶⁰ *Po aty*, fl. 102. Pjesë nga diskutimi i Shules [Kristo Themelkos]: "Kur erdhëm në Tiranë dhe shkuam në Jugosllavi për të vizituar frontin e luftës, atje pashë se si vrisnin dhe i vrisnin haptazi dhe jo fshehur si ne, bile një anëtar të shtabit të Mihajlloviçit e vranë në mes të popullit pa bërë gjyqin fare... Mënyra sesi vepronin në Jugosllavi ish ndryshe nga e jona dhe kjo nuk më pëlqeu që ne keshëm ndaluar vrasjet e rekuizimet. Kjo gjendje më bëri të mos mbaj mendimin e Beratit, duheshte të kishim vranë".

⁶¹ *Po aty*, fl. 118. Pjesë nga fjala e Hysni Kapos: "Të mbajmë lidhje të ngushta me P. J. të dëgjojmë këshillat e saj, të mos ndahemi as një qime nga ajo dhe të ecim në rrugën e drejtë sipas këshillave të saj ashtu si ajo na ndihmoi që në fillim të formimit të Partisë gjatë luftës, dhe na jep çdo ndihmë dhe sot".

⁶² *Po aty*, fl. 204.

⁶³ *Po aty*, fl. 213.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 221. Mbledhja e Byrosë Politike e datës 1 janar 1948.

⁶⁵ *Po aty*.

PKJ-ja e kishte akuzuar PKS-ën se ekzistonte një fraksion antijugosllav në parti dhe ky fraksion cenonte rëndë marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Enver Hoxha nuk mund të lejonte që kundërshtarët e afrimit të mëtejshëm me Jugosllavinë të bëheshin pengesë. Edhe pse pengesa kryesore Nako Spiru nuk ishte më, përsëri kishte njëfarë rezistence në radhët e PKS-ës ku emrat e cilësuar nga Koçi Xoxe do të ishin ata që do të goditeshin në Plenumin VIII për të cilin do të flasim më poshtë. Më datë 5 janar 1948, në mbledhjen e radhës, Kryeministri Hoxha bëri një ekspozitë të gjatë që nga Mbledhja e Beratit (1944) e deri në fundin e vitit 1947 lidhur me marrëdhëniet me jugosllavët.⁶⁶ Nuk hezitoi aspak të ripërsëriste besimin e madh që duhej të kishte partia te PKJ-ja dhe se vetëm në këtë mënyrë do të forcohej udhëheqja e PKS-ës.⁶⁷ Hoxha gjithashtu nuk hezitoi ta quante të gabuar Mbledhjen e Beratit madje, theksoi se ishte tendencioze nga ana e fraksionistëve me në krye Nako Spirun e Sejfulla Malëshovën.⁶⁸ Edhe veten nuk e la pa "faj" sepse, sipas tij, po ta kishte parë çështjen drejt, Nako Spiru do të demaskohej që atëherë.⁶⁹ Nako Spiru nga Enver Hoxha u sulmua edhe si njeriu që kishte goditur unitetin dhe se kishte përfutur shumë nga grindjet politike të Shqipërisë me Jugosllavinë.⁷⁰ Po sipas Hoxhës, Nako Spiru kishte punuar që Shqipëria të afrohej më fort me sovjetikët duke synuar largimin prej jugosllavëve.⁷¹ I vetmi person, sipas Hoxhës, që i shihte realisht gjërat në parti ishte Koçi Xoxe madje, shumë më drejt se ai vetë.⁷² Dy ditë më vonë, më datë 7 janar 1948, Byroja Politike doli me vendim duke e cilësuar punën e Nako Spirut si fraksioniste dhe Mbledhja e Beratit duhej të rishikohej plotësisht.⁷³

Në mbledhjen e parafundit të Byrosë të datës 22 janar 1948, Xoxe duke parë edhe triumfin e politikës së tij projugosllave, si për t'i vënë vulën çështjes së kundërshtarëve, theksoi se ishte e qartë se Nako [Spiru] ishte haptazi kundër jugosllavëve.⁷⁴ Spiru sipas Xoxes ishte mbështetës i

⁶⁶ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1948, D. 53, fl. 287. Dosja 53 është vijim i dosjes 52.

⁶⁷ *Po aty*, fl. 287-288.

⁶⁸ *Po aty*, fl. 291.

⁶⁹ *Po aty*.

⁷⁰ *Po aty*, fl. 293.

⁷¹ *Po aty*.

⁷² *Po aty*. Pjesë nga diskutimi i Enver Hoxhës në mbledhjen e Byrosë, të datës 5 janar 1948: "Koçi e shifte këtë më realisht, shumë më drejt se unë, por unë nuk përfitova".

⁷³ *Po aty*, fl. 298.

⁷⁴ *Po aty*, fl. 392.

intelektualëve, duke bërë që hendeku dallues mes tyre [intelektualëve] dhe popullit shqiptar të ishte shumë i madh.⁷⁵ Kjo fjalë e tij i parapriu mbledhjes së fundit të datës 22 janar 1948, ku u mor përfundimisht në shqyrtim oferta jugosllave e në të cilën ministri i Brendshëm u shpreh hapur mbi vijimin e forcimit të bashkëpunimit politik.⁷⁶ Ofertën e Jugosllavisë, Xoxe e quajti një moment të ri në jetën e PKSH-së.⁷⁷ Çështjen e bashkimit Xoxe e cilësoi si efekt logjik që do të unifikonte të dy popujt në rrugën e socializmit dhe mbetej vetëm për të përcaktuar se cila do të ishte forma, federale apo diçka tjetër.⁷⁸ Vetëm te kjo pikë Xoxe theksoi se duhej pyetur Stalini si mund të quhej ky bashkim dhe duhej marrë pëlqimi i Bullgarisë, Rumanisë dhe Jugosllavisë së Titos.⁷⁹ Sipas Xoxes, interpretimi që i bënte Nako Spiru çështjes së pavarësisë së vendit ishte i gabuar, sepse Shqipëria kishte nevojë për ndihmë nga të gjitha drejtimet dhe vetëm në këtë mënyrë do të arrihej bashkimi kur Shqipëria dhe Jugosllavia të ishin një shtet, një konfederatë.⁸⁰ Me qëndrim triumfatori, Xoxe u shpreh pa doreza se:

"...unë e kam luftuar këtu politikën indipendente shoviniste të Nakos, borgjeze, të mos bija në gabime në këtë sektor pa u konsultuar me shokët jugosllavë dhe sovjetikë".⁸¹

Enver Hoxha nuk e kundërshtoi fjalën e Xoxes dhe, si për t'i vënë vulën, në fjalën e tij ai u shpreh:

"Unë kam thënë se edhe Partia duhet të shkojë në baza federale; pse e gjithë kjo vijë që shtrojmë atje të çon".⁸²

Me këtë frazë dukej qartë se Hoxha nuk e përjashtonte mundësinë e bashkimit. Për të përforcuar më shumë këtë ide, ndërhyri përsëri Koçi

⁷⁵ *Po aty*, fl. 394.

⁷⁶ *Po aty*, fl. 396. Diskutimi i Koçi Xoxes në mbledhjen e Byrosë të datës 22 janar 1948.

⁷⁷ *Po aty*.

⁷⁸ *Po aty*. Pjesë nga fjala e Koçi Xoxes: "Ky bashkëpunim është në lidhje të ngushtë edhe me Partinë, dhe këtu do të shtrohet me marrë eksperiencë në instruktorë, me këshilltarë. Në momentin e sotëm kështu duhet ta përcaktojmë bashkëpunimin, që marrëdhëniet ekonomike, kulturele ushtarake etj., të na çojnë si dy popuj drejt bashkimit, drejt socializmit; përsa i përket formës shtet federal ose tjetër, kjo është një çështje tjetër, kjo është e Stalinit, e Kampit anti imperialist".

⁷⁹ *Po aty*.

⁸⁰ *Po aty*.

⁸¹ *Po aty*.

⁸² *Po aty*, fl. 397.

Xoxe duke u shprehur se pa Jugosllavinë Shqipëria si vend i vogël dhe i prapambetur nuk mund të shkonte përpara prandaj duhej afrimi i plotë në ushtri, ekonomi, kulturë etj., pasi vetëm kështu do të arrihej bashkim vëllazërimi.⁸³

Është e dukshme se me këto mbledhje maratonë të Byrosë Politike që kishin filluar që më datë 23 dhe 30 dhjetor 1947 e të përfunduara më 22 janar 1948, i ishte vënë vula e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë. Megjithatë, për mua si studiues mbetet një ngërç i pazgjidhur. Tek të gjitha këto mijëra faqe të hulumtuara, nuk më rezultoi askund që të ishte marrë vendimi për të vijuar procedurat për bashkim. Në dosjen ku flitet për një nga mbledhjet e lartpërmendura të Byrosë Politike, e që duhet thënë se është mjaft e ndjeshme, tregohet e gjithë paaftësia dhe varësia e udhëheqjes politike komuniste shqiptare ndaj Jugosllavisë, ndodhet një sqarim tronditës. Në fund të saj është një shënim me mbishkrimin "Tepër Sekret; vetëm për sh. "X".* Vetë bashkëshortja e diktatorit, Nexhmije Hoxha, e ka parë këtë dosje siç jepet nga shënimimi pasardhës më datë 27 qershor 1981. Nuk përmendet nëse znj. Hoxha ka dhënë urdhër për të hequr disa fletë nga kjo dosje, por në shënimin e fundit të mbledhja e datës (...) janar 1948 të po kësaj dosjeje, mungojnë fletët 333/1, 333, 336, 336/1, 337/1, 338, 338/1, 339/1, 340, 340/1, 342 dhe 342/1, të cilat me porosi (pa specifikuar se nga kush) i ishin dhënë personit "X" dhe jepej porosia e prerë me firmë të njërit prej drejtuesve të arkivit "ky material të mos i jepet asnjëri".⁸⁴ Mos ndoshta tek ato fletë gjendet aprovimi nga Byroja Politike e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë?

Plenumi VIII i PKSH-së dhe nënshtirimi zyrtar ndaj tutelës jugosllave

Fillimi i vitit 1948 tregoi se PKSH-ja e kishte të pamundur të drejtonte vendin pa ndihmën dhe tutelën jugosllave. Ky fakt ishte kuptuar edhe nga Byroja Politike e KQ të PKSH-së, e cila u mblodh në një

⁸³ *Po aty.*

* Pas një dileme dhe refleksioni personal vendosa të mos ta bëj të ditur emrin e personit që ka marrë këtë dosje dhe fletët e sipërcituara atëherë, pasi bëhet fjalë për një nga figurat më të dukshme të historiografisë shqiptare në vitet '70-'80-'90. Do ta quaj thjesht personi "X".

⁸⁴ *Po aty*, fl. pa numër, Tiranë, 3 korrik 1981.

mbledhje të posaçme në janar të vitit 1948 për të treguar edhe një herë se sa e çmuar ishte "dashuria" për Jugosllavinë.⁸⁵ Fajin për të gjitha shtrembërimet e vijës së drejtë të partisë iu faturuan "armikut" më të rrezikshëm Nako Spiru, i cili kishte pasur si detyrë (pa specifikuar se nga kush) të bënte *fuksion* (spionllëk) dhe të dëmtonte partinë.⁸⁶ Duke qenë se Byroja Politike kishte bërë një "analizë" të thellë kishte arritur në përfundimin se puna e Spirit dhe e klikës së tij ishte e pandarë nga ajo e fraksionistëve dhe devijuesve të tjerë, e madje ishte më i rrezikshëm sesa ata në të gjitha pikëpamjet për PKS-h-në.⁸⁷

Në këtë mbledhje pranohet hapur se PKJ-ja kishte luajtur një rol me rëndësi dhe kishte ushtruar një ndikim të madh në formimin e PKS-h-së.⁸⁸ Në fjalën e tij, Koçi Xoxe ishte shprehur se faj për ndikimin e intelektualëve në parti kishte pasur me ndërhyrjet e tij edhe Miladini [Popoviçi], çka kishte vonuar në krijimin e një bërthame punëtore në parti e cila do të bëhej shtylla e saj.⁸⁹ Po sipas Xoxes, ardhja e shokëve jugosllavë Velua dhe Dizdari (në dokument nuk jepet emri dhe pozita e tyre) të cilët kishin sjellë direktiva nga Komiteti Central i PKJ-së kishte bërë të mundur kthesën në parti që nga Mbledhja e Beratit dhe goditjen e elementëve sektarë si Liri Gega.⁹⁰ Gjithashtu, në këtë mbledhje u sulmua përsëri Sejfulla Malëshova sepse ishte përpjekur ta shtrembëronte vijën e

⁸⁵ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1948, D. 42, fl. 1. Material përmbledhës i çështjeve të analizuar në mbledhjet e Byrosë Politike, në janar të vitit 1948 si dhe procesverbali i mbledhjes së Plenumit VIII mbajtur në datat 26 shkurt-8 mars 1948.

⁸⁶ *Po aty*.

⁸⁷ *Po aty*. Pjesë nga raporti përmbledhës i mbledhjes së Byrosë Politike: "Pa një analizë të tillë e cila është e vetmja analizë e plotë që ka bërë Partia jonë, nuk mund të kuptohet mirë puna armiqësore e Nako Spiros dhe e klikës së tij, sepse ajo nuk mund të shkëputet nga puna e vjetër e fraksionistëve dhe deviatorëve të Partisë [Anastas] Lulua, Xhepi [Sadik Premtja], Liri Gega, Ymer Dishnica, Sejfulla Malëshova. Përkundrazi fraksioni i Nako Spiros është vazhdimi i tyre, vetëm dallohet nga të tjerët se ka qenë më i rrezikshëm në të gjitha pikëpamjet për Partinë tonë; është lufta e vazhdueshme e Partisë t'onë, kundër elementit mikroborgjez, armikut të klasës që ka për qëllim të futet e ta marrë në dorë Partinë për t'ia dorëzuar armikut ose për ta shkatërruar nga brenda. Partia ka patur vijë të drejtë".

⁸⁸ *Po aty*. "Partia Jugosllave lojti një rol me rëndësi dhe ushtroi një influencë të madhe në formimin e Partisë s'onë. Grupet komuniste kishin ndërjet dhe kërkonin tek ajo t'u thoshte fjalën e saj dhe t'u tregonte rrugën sesi duhej vepruar, sepse ajo ishte një Parti e fortë me eksperiencë dhe që po korrite suksese në luftën e saj".

⁸⁹ *Po aty*, fl. 2.

⁹⁰ *Po aty*, fl. 5.

partisë sipas pikëpamjeve të tij thellësisht oportuniste.⁹¹ Po aq i rrezikshëm për partinë madje ca më shumë, u etiketua Nako Spiru puna e të cilit u konsiderua "punë e një armiku".⁹²

Në këtë mbledhje Byroje, Spirit nuk iu fal puna që kishte bërë kundër rënies së vendit nën tutelën jugosllave, duke shkaktuar sipas Hoxhës në fjalën e mbajtur jo pak probleme në marrëdhëniet vëllazërore mes popullit shqiptar dhe atij jugosllav.⁹³ Në mbledhje u përmend edhe një fakt i rëndësishëm, sipas të cilit Spiru kishte deklaruar pas nënshkrimit të konventës ekonomike me Jugosllavinë se u "shit Shqipëria".⁹⁴ Një tjetër element që nuk i falej Nako Spiritu qëndronte në faktin se kishte kërkuar të bëheshin marrëveshje me BS-në, pa u konsultuar fare me Jugosllavinë.⁹⁵ Po ashtu, Spiru kishte bërë përpjekje që plani ekonomik i Shqipërisë të ishte i shkëputur nga ai i Jugosllavisë në frymën e "indipendencës" siç u etiketua në këtë mbledhje.⁹⁶ Pra, Nako Spiru vetëm pse kishte dashur të mbante të pavarur ekonomikisht Shqipërinë, ishte armik dhe kishte punuar në dëm të partisë e të popullit! Nako Spiru sipas "gjetjeve" në mbledhje kishte favorizuar njerëz si Mehmet Shehu, ndërsa të tjerë shokë besnikë si Pandi [Kristo] sulmoheshin si të paaftë.⁹⁷

⁹¹ *Po aty*, fl. 6.

⁹² *Po aty*. "Puna e Nako Spiros, është një punë prej armiku, një punë anti-parti, një fraksion mbrenda në Parti për të marrë Partinë në dorë dhe për t'ia dorëzuar armikut. Kjo punë e tij armiqësore drejtohej kundër interesave të popullit, për të shkatërruar pozitën e fituara gjatë luftës, për të futur vendin në një qorrsockak, duke përgatitur këtu terrenin armikut".

⁹³ *Po aty*, fl. 7.

⁹⁴ *Po aty*, fl. 8.

⁹⁵ *Po aty*, fl. 10.

⁹⁶ *Po aty*, fl. 11. "Në lidhje me zgjidhjen e problemit t'onë ekonomik, me zhvillimin e ekonomisë t'onë popullore, Partia kishte caktuar kjo vijë e saj, ekonomia jonë do të zhvillohej dhe do të përparonte vetëm me mbështetjen e ekonomisë së RPFJ duke ndjekur rrugën e koordinimit të planit. Përgjegjësinë që Partia i kish caktuar Nako Spiros, për drejtimin e ekonomisë së Shtetit ai e shfrytëzoi në dëm të Partisë dhe të popullit. Nako Spiru përgatiti një plan pesëvjeçar krejt në kundërshtim me koordinimin e planeve me Jugosllavinë. Ai bëri një projekt plan ireal dhe autarkik, në frymën e "indipendencës", që synonte të merrte sa më shumë nga Jugosllavia dhe të mos jepte po të qe e mundur asgjë. Bëri një plan të fryrë, që i premonte hënzën popullit (ngritja e nivelit të masave në maksimum) dhe që kishte për qëllim të shkaktonte demoralizim dhe demobilizim në masa dhe në parti vetë dhe të shpinte në shkëputje me Jugosllavinë".

⁹⁷ *Po aty*, fl. 14. "Shokut Gogo i ka thënë në mbledhje të Ministrave se ti je gënjeshtar, për Shulen me qëllim që ta nxirrte të paaftë thoshte se Drejtorja Politike i bie legenit,

Mehmet Shehut, sipas mbledhjes, çdo "sëmundje" që binte në parti e zinte të parin dhe së bashku me [Liri] Belishovën e Fadil Paçramin ishin lidhur me ndërgjegje me qëllimet fraksioniste dhe armiqësore të Nako Spirut.⁹⁸ Kjo mbledhje e Byrosë Politike e zhvilluar në janar të vitit 1948 (data nuk cilësohet në dokument) ishte pararendëse e "zulmëmadhit" Plenumit VIII të KQ të PKSH-së.

Ky plenum u mbledh menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve lokale në Shqipëri më datë 26 shkurt 1948 dhe përfundoi më 8 mars 1948.⁹⁹ Është një nga plenumet më të gjata në historinë e PKSH-së dhe siç do të shprehej më vonë në Plenumin XI Enver Hoxha, i mbajtur në datat 13-24 shtator 1948 për të cilin do të ndalemi më poshtë, si një nga plenumet e ditës më të errët për partinë. Në Plenumin VIII u vendos që Mehmet Shehu dhe Liri Belishova të mos merrnin pjesë.¹⁰⁰ Ky plenum do të "ligjëronte" mbledhjen e Byrosë Politike të mbajtur në janar pasi të ishte studiuar në detaje ajo mbledhje. Personat që ishin ftuar të merrnin pjesë në këtë plenum sipas Enver Hoxhës kishin shumë pak dijeni mbi atë se çfarë kishte ngjarë në mbledhjen e Byrosë.¹⁰¹ Nuk ishte rastësi që shumica e personave të ftuar nga rangjet e larta të partisë ishin ata që Nako Spiri i kishte konsideruar të paaftë.

Në këtë plenum të turpshëm u risollën edhe një herë në vëmendje të pjesëmarrësve "gabimet" tepër të rënda të Nako Spirut që nga Mbledhja e Beratit e deri te viti 1947 kur ai kishte vrarë veten. Në plenum u ripërsërit pa fund fakti se aleanca me Jugosllavinë ishte një nga fitoret më të mëdha të Shqipërisë dhe se Nako Spiri nuk e kishte pranuar këtë fakt.¹⁰² Në fjalën e tij, Enver Hoxha u shpreh me shumë besim se kishte qenë një

ndërsa ai tjetri (për Mehmetin) bën kurset e dynjasë, nxjerr kuadro ushtarake dhe ka organizuar punën si duhet. Për Petro Papin thosh se është mirë të ruajë ndonjë depo, për jo për kuadro. Haki Toskës i përsëriste gjithmonë: "ty kot të kanë sjellë këtu, të të dërgojnë nga Delvina në ndonjë qoshe, për atje bën ti". Për të luftuar shokun Pandi sa herë që e sillte rasti të flitej për Komisionin e Kontrollit, thoshte se atje s'bëhet gjë fare, se ne s'kemi Komision Kontrolli, etj."

⁹⁸ *Po aty*, fl. 19.

⁹⁹ *Po aty*, fl. 21. Procesverbal i mbledhjes së Plenumit VIII të KQ të PKSH-së mbajtur nga data 26 shkurt deri më 8 mars 1948.

¹⁰⁰ *Po aty*.

¹⁰¹ *Po aty*.

¹⁰² *Po aty*, fl. 23.

gabim i madh nga ana e partisë që të sulmoheshin Koçi Xoxe, Kristo Themelko dhe Tuk Jakova.¹⁰³

Nga Koçi Xoxe u shkua edhe më tej në identifikimin e "armiqve" brenda radhëve të partisë deri në mbledhjen e Mukjes, ku, pa dyshim, figurën që goditi më fort ishte ajo e Ymer Dishnicës.¹⁰⁴ Për Xoxen, besnikëria ndaj vijës së PKJ-së duhej të ishte e padiskutueshme.¹⁰⁵ Të gjithë diskutantët e tjerë në këtë mbledhje duke filluar nga Naxhije Dume e deri tek Enver Hoxha e Koçi Xoxe në fund, të gjithë mbollën vrer kundër Nako Spirut dhe ngritën në qiell aleancën me Jugosllavinë.¹⁰⁶ Politika e ndjekur nga Spiru u etiketua si devijim nga çështjet ekonomike dhe në marrëdhëniet me Jugosllavinë.¹⁰⁷

Diskutimet që vijuan në këtë plenum maratonë të thuash ishin qesharake, është pak. Haki Toska pjesëmarrës në plenum diskutoi në datën 3 mars 1948 duke u shprehur se, edhe pse nuk ishte njohur tërësisht me materialin, por vetëm nga sa ishte biseduar e kishte "kuptuar" shumë qartë tradhtinë e Nako Spirut.¹⁰⁸ Në të njëjtën linjë me të, por më i moderuar u tregua në diskutimin e tij Kiço Ngjela, i cili i mundua të shfajësohej se nuk i kishte kuptuar sa duhet "atëherë" oportunizmin dhe sektarizmin.¹⁰⁹ Ngjela ishte një nga negociatorët kryesorë së bashku me Spirun për sa u përkiste marrëdhënieve ekonomike të Shqipërisë me Jugosllavinë, prandaj diskutimi i tij duhej të ishte një autokritikë dhe t'i "pëlqente" udhëheqjes. Grupi më "i krekosur" në këtë plenum ishte pa dyshim ai i Koçi Xoxes me Pandi Kriston dhe Nesti Kerenxhin. Veçanërisht ky i fundit e vuri theksin te mungesa e unitetit në Byronë Politike, në mënyrë që të ndërtohej një udhëheqje e fortë.¹¹⁰ Marrëdhëniet me Jugosllavinë, Kerenxhi u shpreh se ishin të paprekshme dhe madje shkoi deri aty sa duke iu drejtuar Enver Hoxhës në plenum i kujtoi se

¹⁰³ *Po aty*, fl. 26.

¹⁰⁴ *Po aty*, fl. 30.

¹⁰⁵ *Po aty*.

¹⁰⁶ *Po aty*, fl. 31-58. Folësit në plenum sipas dokumentacionit të hulumtuar ishin: Naxhije Dume, Nesti Nase, Manush Myftiu, Koçi Xoxe, Adil Çarçani, Petro Papi, Koço Titka, Enver Hoxha (disa herë), Beqir Balluku, Bajram Sinoymeri, Pëllumb Dishnica, Tahir Kadare, Sotir Kamberi, Bedri Spahiu, Rrahman Përlaku, Hysni Kapo, Tuk Jakova.

¹⁰⁷ *Po aty*, fl. 59.

¹⁰⁸ *Po aty*, fl. 72.

¹⁰⁹ *Po aty*, fl. 73.

¹¹⁰ *Po aty*, fl. 77.

dikur kishte thënë se Shqipëria do të afrohej me BS-në vetëm nëpërmjet Jugosllavisë.¹¹¹

Në dy ditët në vijim, debatet degjeneruan deri në çështje personale intime të "armiqve" të partisë të cilëve po u bëhej gjyqi politik. Për arsye etike nuk po përmend asnjë prej diskutimeve të mëposhtme, pasi do të cenonin vlerën e këtij studimi. Koçi Xoxe dhe grupi i tij kishin dalë triumfatorët më të mëdhenj të këtij plenumi. Dukej sikur fuqia e tyre sa vinte e rritej. Në çdo faqe të procesverbalit të mbajtur për këtë plenum thuajse të gjithë diskutantët shpreheshin "siç tha edhe shoku Koçi", apo thjesht "Koçi".¹¹² Ironia e fatit do të ishte se shumica e gjithë këtyre diskutantëve, të cilët më së shumti i thurnin lavde punës së Xoxes dhe sulmonin pa mëshirë "armikun" Nako Spiru e anëtarë të tjerë të partisë, do të ishin po të njëjtët siç do ta shohim në vijim të studimit ata që do të ndryshonin kurs 180° vetëm nëntë muaj më vonë në Kongresin I të PKSH-së dhe me të njëjtin zell siç iu kundërvunë për së vdekuri Nako Spiru, do t'i kundërviheshin për së gjalli Koçi Xoxes dhe të të ashtuquajturit grup i tij. Ky plenum tregoi qartë se Shqipëria vijonte të mos kishte klasë politike, një sëmundje e cila ka lënë gjurmë të thella edhe në epokën e postdiktaturës.

Në plenumin e radhës të mbajtur në datën 27 mars 1948, goditja ndaj Nako Spiru (pas vdekjes), Mehmet Shehut, Liri Belishovës, Ymer Dishnicës, Sejfulla Malëshovës vijoi. Të gjithë këta u quajtën fraksionistë dhe ndaj tyre u morën vendime të rënda politike. Rezolucioni i Plenumit

¹¹¹ *Po aty*, fl. 79. Pjesë nga fjala e Nesti Kerenxhit në Plenumin VIII: "Për marrëdhëniet me Jugosllavinë: Kam qenë edhe unë atëherë me Komandantin i cili na tha që në të ardhmen neve ndihmën e Bashkimit Sovjetik do ta marrim nëpërmjet Jugosllavisë. Neve kësaj i kemi shkarë. U arrijtën marrëdhëniet me Jugosllavinë. U përcaktua koordinimi i planeve por neve shkajtëm duke arrijtur të thomë se neve mund të bëjmë edhe pa Jugosllavinë. Kjo është çfaqur në shoqëritë, në lidhje me teknikët jugosllavë, këta nuk pyeteshin, nënvleftësoheshin, nuk përfilleshin, nuk kishte me ta marrëdhënie miqësore, nuk bashkëpunoheshin. Këto i ka shfrytëzuar armiku. Në Kuçovë bie fjala, është ngritur zotësia e teknikëve italianë dhe është ulur vlera e jugosllavëve. Një gjë e tillë ka dalë edhe më e theksuar në Selitë. Kjo shfrytëzohej nga armiku, i cili i mobilizonte punëtorët kundër shoqërive. Këto ngjisinin edhe në aeroport, sepse atëherë çështja e monedhës nuk shtrohej siç shtrohet sot. U krijua frika se na ikën leku për në Jugosllavi. Armiku nuk donte më tepër se kaq".

¹¹² *AQSH*, F. 14/OU, V. 1948, D. 42/1, fl. 138-333. Procesverbal, dorëshkrim i mbledhjes së Plenumit VIII të KQ të PKSH-së.

VIII¹¹³ duhej t'i shpërndahej të gjithë anëtarëve të partisë ku të gjithë duhej të njoftoheshin se ç'armik i rrezikshëm kishte qenë Nako Spiru dhe emrat e tjerë të cituar më lart. U vendos që Mehmet Shehu dhe Liri Belishova të mos ishin më anëtarë të KQ të PKSH-së.¹¹⁴ Gjithashtu, për Belishovën u mor masa e rëndë e përjashtimit të saj nga partia së bashku me Ymer Dishnicën dhe Sejfulla Malëshovën.¹¹⁵ Në rezolucion u vendos që rruga më e shpejtë për zhvillimin e Shqipërisë ishin lidhjet e ngushta me Jugosllavinë e Titos deri në bashkimin e plotë ekonomik.¹¹⁶ Më datë 27 mars 1948, u aprovua njëzëri ky rezolucion dhe u urdhërua që të punohej në të gjitha organizatat e partisë nga data 1 deri më 10 prill 1948.¹¹⁷

Koçi Xoxe pas triumfit në Plenumin VIII, donte t'i lante hesapet sa më shpejt që të ishte e mundur me kundërshtarët e tij potencialë në parti. Ai ia kishte dalë mbanë të përjashtoheshin nga partia Belishova, Dishnica dhe Malëshova, por jo Mehmet Shehu. Ndoshta këtij të fundit ia kishte frikën më shumë dhe siç do të tregojnë ngjarjet e mëtejme do të kishte të drejtë. Është zhvilluar në fakt sipas dokumenteve që kam hulumtuar, një debat i fortë mes Xoxes dhe Shehut në celulën e partisë së Ministrisë së Komunikacionit [Shehu ishte ministër në këtë dikaster], ku ndërmjet të tjerash, Xoxe e ka quajtur atë "fraksionist" sipas atyre që ishin thënë në mbledhjen e Byrosë Politike.¹¹⁸ Mehmet Shehu doli kockë e fortë për

¹¹³ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1948, D. 43, fl. 30-44. Projektrezolucioni, rezolucioni si dhe procesverbali i mbledhjes së Plenumit të KQ të PKSH-së, më datë 27 mars 1948.

¹¹⁴ *Po aty*, fl. 36.

¹¹⁵ *Po aty*.

¹¹⁶ *Po aty*, fl. 37-38. Pjesë nga rezolucioni i Plenumit VIII: "IV. Partia e jonë e shikon se lidhjet më të ngushta dhe bashkëpunimi i plotë me Jugosllavinë e Mareshallit Tito, janë rruga më e shpejtë, më e sigurtë dhe e natyrshme, që krijon mundësitë për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Partia e shikon se bashkimi ekonomik në mes të Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe gjithë format e bashkëpunimit në mes tyre, që rrjedhin nga ky bashkim, përbëjnë hallkën kryesore që sot në praktikë na sigurojnë këtë rrugë. Armiqtë janë përpjekur dhe do të përpiqen ta godasin këtë vijë. Detyra e Partisë është të godasë ashpër këta armiq dhe të shtojë e të forcojë bashkëpunimin sa më të ngushtë dhe vëllazërimin sa më të shëndoshë me popujt e Jugosllavisë federative".

¹¹⁷ *Po aty*, fl. pa numër.

¹¹⁸ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1948, D. 46, fl. 10. Diskutime të Mehmet Shehut me Koçi Xoxen në celulën e Ministrisë së Komunikacionit, prill 1948.

Koçi Xoxen. Ai në të dyja diskutimet që zhvilloi i pranoi vendimet e partisë, por deklaroi me forcë se "fjalën fraksionist nuk e pranoj".¹¹⁹

Mehmet Shehu do të ishte një nga figurat më të goditura nga ana e strukturave të PKSH-së pas Plenumit VIII. Situata e tij ishte tejet e nderë. Me vendim të PKSH-së u hoq nga qarkullimi çdo shkrim i Nako Spirut dhe Mehmet Shehut, por këtij të fundit iu la një hapësirë për "reflektim".¹²⁰ Sipas Manush Myftiut (anëtar i KQ të PKSH-së), te botimet e Shehut shihej vetëbesimi i tepruar dhe kërkohej një kritikë e shëndoshë për këto botime.¹²¹

...vijon në numrin e ardhshëm

Bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Fondet: 14/Organet Udhëheqëse (OU): 1947, 1948.

F. 506/Banka e Shtetit Shqiptar (BSHSH): 1947

Literaturë historiografike:

Boriçi, Gjon. *Fillimet e marrëdhënieve politiko-ekonomike shqiptaro-kineze 1954-1960*. Tiranë: Geer, 2023.

Boriçi, Gjon. *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1978*. Tiranë: Mirgeeralb, 2016.

Boriçi, Gjon. *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1978*, bot. II. Tiranë: Geer, 2022.

DeLong, J. Bradford. *Slouching towards utopia; an economic history of the Twentieth Century*. London: Basic Books, 2022.

Lauka, Islam & Ymeri, Eshref. *Antologjia e Kryqëzimit; Rusia dhe çështja shqiptare (1878-2012)*. Prishtinë-Tiranë: City Design: 2012.

Mastny, Vojtech. *Il dittatore insicuro: Stalin e la Guerra Fredda*. Përkthyer nga anglishtja prej Annalisa Agratit, Milano: Tea, 1998.

¹¹⁹ *Po aty*. Debati ndërmjet Koçi Xoxes dhe Mehmet Shehut. "Unë titullin fraksionist nuk e pranoj..."; shih edhe fletën 9 diskutimin me shkrim dore të Mehmet Shehut.

¹²⁰ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1948, D. 83, fl. 2. Vendim i Byrosë Politike, i datës 4 maj 1948, për heqjen nga qarkullimi të dy botimeve të Mehmet Shehut "Kujtime nga lufta e Brigadës së Parë", "Lufta për çlirimin e Tiranës".

¹²¹ *Po aty*, fl. 10.

Unkovski-Korica, Vladimir. *The economic struggle for power in Tito's Yugoslavia; from World War II to Non-Alignment*. London: I.B. Tauris, 2016.

West, Richard. *Tito and the rise and fall of Yugoslavia*. London: Faber and Faber, 1996.

...continues from the previous issue

GJON BORIÇI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
gjon.borici@asa.edu.al

S u m m a r y

A VIEW IN POLITICAL -ECONOMIC TERMS BETWEEN ALBANIA AND YUGOSLAVIA
IN THE PERIOD 1945-1949
(PART TWO, JULY 1947- MARCH 1948)

In this paper my main focus has been in the period July 1947-March 1948 when the communist Albanian leadership agreed to fully be attached to Yugoslavia politically and above all economically. This period was very astonishing because saw important changes within the Albanian leadership culminating with the suicide in the office of Nako Spiro, one of the key figures of the communist regime in Albania. Spiro was one of the strongest opponents of rejecting the plan for Albania to be swallowed within Yugoslavia and for his objection he paid with his own life. Just as Spiro has removed himself from the part with his death, Enver Hoxha and the number two of the regime Koçi Xoxe hastened to pave the way for Albania to join Yugoslavia in the form a federation. Important elements are shown to us from the careful research of the archives and of the international bibliography that Yugoslavia would pay to Albania 21 billion dinars (\$480 million dollars) in case of accepting the Yugoslav plan. The marathon meetings of Albania's Communist Party Politbureau starting since the last days of December 1947 and culminating in January 1948, unanimously agreed to accept the Yugoslav proposal for Albania to join the federation plan offered by Yugoslavia. This plan was also welcomed even by the leader of the Soviet Union, Joseph Stalin.

...to be continued

